


DHJETË VITE SHTET: Cilat janë 10 arritjet dhe 10 ngecjet që karakterizuan dekadën e parë të Pavarësisë?

—



Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Është një organizatë e pavaraur, jopartiake dhe jo-fitimprurëse e politikave publike me qendë në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të zhvillojmë hulumtime të besueshme në fushën e politikës, ligjit dhe ekonomisë dhe të shtyjme përpara zgjidhjet e politikave që adresojnë dështimet dhe/ ose trajtojnë problemet në fushat e politikave të lartpërmendura.

Analizë Politikash 03/2018

10 VITE SHITET: Cilat janë 10 pluset dhe 10 minuset që e karakterizuan dekadën e parë të Pavarësisë?

Mars 2018

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Mars, 2018.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e stafit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, donatorëve e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Ueb : www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

10 VITE SHITET: CILAT JANË 10 PLUSSET DHE 10 MINUSET QË E KARAKTERIZUAN DEKADËN E PARË TË PAVARËSISË?

Hyrje

Për Kosovën, 2018-a përbën vitin jubilar. Ajo ka shpallur pavarësinë nga Serbia më 17 shkurt të 2008-s dhe rrugëtimi njëdekadësh i shtetit prej më të rinjve në botë, ka njohur ngritje e rënie. Në këtë punim janë përmbledhur zhvillimet më kryesore që kanë ndodhur brenda dhjetë viteve të para, të kategorizuara në suksese e dështime.

Sfidë më vete ka qenë gjetja e 10 zhvillimeve që mund të kualifikohen si suksese. Megjithëkëtë, të tillat hasen kryesisht në vitet e para të shtetësisë. Është e kuptueshme që vet akti i shpalljes së pavarësisë përbën arritjen më të madhe për Kosovën, por ai merr kuptim pas njohjeve që Republikës i erdhën nga vendet më të fuqishme perëndimore dhe nga më shumë se gjysma e vendeve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Gjurmë la opinionin i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas të cilit shpallja e pavarësisë nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Në zhvillimet e mëdha, lart zë vend edhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, marrëdhënia e parë kontraktuale që Kosova lidhi me Bashkimin Evropian. Vendi i mban dy rekorde të bardha në rajon: Për të drejtat e shtuara për komunitetet pakicë dhe për politikën e rrepta kundër ekstremizmit të dhunshëm e terrorizmit.

Ka qenë e lehtë të identifikohen dështime që kanë ndodhur përgjatë dekadës. Ka pasur shumë të tilla dhe sfidë më vete ka përbërë përzgjedhja e vetëm 10 prej tyre. Në krye të top-dështimeve listohet dialogu me Serbinë, proces nëpërmjet të cilit Kosova e bëri fqinjin verior faktor në trajtimin e shumë temave që do të duhej të përbënin çështje të brendshme të shtetit të ri. Procesi frenoi forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. Në anën tjetër, Kosova nuk mbërri ta ndjek hapin me të cilin ecnin vendet e rajonit drejt BE-së dhe për pasojë, as tash, ajo nuk ka një perspektivë të qartë evropiane, sikundër që shtetasit i ka të mbërthyer në geto, duke qenë të vetmit në Evropë që nuk mund të lëvizin pa viza në Zonën Schengen. Shteti i ri mban rekorde të zeza në rajon për një numër problemesh. Ka ekonominë më të pazhvilluar e papunësinë më të lartë. Veç këtyre, e ka edhe korrupsionin në vlim. Ngecje pati në shumë sektorë, dhe më të vërejtshmet janë në shëndetësi e arsim. Në anën tjetër, duke qenë i ndikuar nga politika, sistemi i drejtësisë ndodhet larg përmbushjes së misionit.

Ky punim përbën përmbledhje të dhënash telegrafike për zhvillimet e ngjarjet më kryesore që kanë ndodhur në dekadën e parë të Kosovës shtet. Është katalog informatash përmbledhëse. Qëllimshëm, në masë minimale është komentuar e analizuar mbi të dhënat faktike që janë ofruar.

10 MINUS

Dialogu i Kosovës për Serbinë

Kosova dhe Serbia i kanë dhënë start në 2011-n një dialogu për “normalizim të marrëdhënieve”, nëpërmjet të cilit fqinji verior, edhe formalisht, u bë faktor në trajtimin e shumë temave që do të duhej të përbënin çështje të brendshme të shtetit të ri. Nuk qenë simetrike dobitë e procesit. Dialogu i zhvilluar në Bruksel nën drejtimin e autoriteteve të Bashkimit Evropian, i cili fillimisht ishte i karakterit teknik e më pastaj avancoi në politik, si arritje më të madhe njeh “Marrëveshjen

e parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”¹, në të cilën vunë inicialet kryeministri i Kosovës dhe ai i Serbisë. Palët ranë dakord për një listë çështjesh. Gjithsej 14 marrëveshje publike janë mbërritur në kuadër të dialogut për normalizim dhe 32 të tjera në kuadër të dialogut teknik. Ekskluzivisht ato trajtojnë tema që kanë të bëjnë me rregullimin e brendshëm të Kosovës.

Disa nga “rezultatet” e marrëveshjeve janë këto: Integrimi i plotë i serbëve akoma nuk ka ndodhur dhe ndarjet janë evidente edhe tash; Nuk është mbërritur shuarja e plotë e strukturave paralele serbe, ndërsa pjesëtarët e formacioneve të armatosura që vepronin ilegalisht në Kosovë janë amnistuar për një gamë veprash penale të dënueshme edhe më shumë se 20 vjet, dhe të tillët janë akomoduar në institucionet e Kosovës; Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, që proklamohej si OJQ, i ish-in njohur edhe kompetenca ekzekutive që janë në kundërshtim me Kushtetutën; Komunave të veriut iu njoh e drejta të kenë rajon të veçantë policor; Komunitet e veriut janë të vetmet që përfitojnë nga i gjithë buxheti që përmban taksat doganore që arkëtohen në dy pikëkalime kufitare me Serbinë; Gjykata e gjithë rajonit të Mitrovicës me shumicë shqiptare drejtohet nga një serb dhe çdo vendim gjyqësor që lidhet me serbët mund të apelohej vetëm pranë një kolegji të përbërë nga një panel gjyqtarësh me përkatësi etnike të njëjtë me ta; Kosova nuk aplikoi reciprocitetin në raport me Serbinë; Kosova nuk mundi të inkasonte nga serbët borxhin për shpenzimin e energjisë dhe as ta bënte KOSTT-n operator të pavarur të sistemit të transmisionit; Marrëveshja për rivitalizim të urës së Ibrit me qëllim krijimin e lëvizjes së lirë, prodhoi një projekt që përmban edhe ndërtimin e një barriere për të penguar qasjen e lirë në sheshin qendror në veri; Në vend të “Republika e Kosovës”, Prishtina zyrtare pranoi të përfaqësohet në nisma rajonale me deniminimin “Kosovo*”, dhe që fusnota për asteriskun të ketë në përmbajtje edhe Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Se marrëveshjet nuk kishin mbërritur efektin që synohej dhe as nuk zbatoheshin, dëshmohej edhe në raportet periodike që Qeveria i ka përcjell në Bruksel. Në të fundit², atë të 2017-s, flitej për “një numër” marrëveshjesh që ishin në pritje të zbatimit, për “disa” që ishin bllokuar plotësisht dhe për “të tjerat” që ishin ndërprerë në faza të ndryshme të zbatimit, por edhe për “disa të tjera” që i ishin nënshtruar vonesave.

Një nga shkaqet që ka prodhuar këtë realitet, ka duhet kërkuar te gjuha e përdorur në marrëveshje. Ajo karakterizohet nga ambiguiteti. Dëshmi më e mirë e kësaj është gjetja e emërimit të mekanizmit ombrellë të komunave me shumicë serbe: Asociacion/Bashkësi, fjalë këto që nuk përbëjnë sinonim.

Në Kosovë, procesi i dialogut është karakterizuar nga mungesa e një platforme, por edhe mungesa e konsensusit dhe e transparencës. Shkaku i kësaj, jo rrallëherë janë organizuar protesta e në Kuvend ka pasur përplasje për një numër marrëveshjesh që pranoheshin nga Qeveria e Kosovës. Rezistencë më të madhe provokoi marrëveshja e fundit për Asociacionin/Bashkësinë, për të cilën Gjykata Kushtetuese gjeti se nuk ishte në frymë me Kushtetutën³.

¹Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve (2013). Në dispozicion, në:

<http://www.kryeministri->

[ks.net/repository/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf).

²Vërejtjet e autoriteteve të Kosovës në lidhje me shkallën e zbatimit të marrëveshjeve nga Serbia, janë të përfshira në një korrespondencë zyrtare të shkruar, që Edita Tahiri, në kapacitetin e ministres për Dialog, ia përcjell drejtoreshës për Ballkanin Perëndimor në Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian të Bashkimit Evropian, Angelina Eichhorst.

Korrespondenca në dispozicion, në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORT -](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORT_-_Marr%C3%ABveshjet_e_Brukselit_n%C3%AB_Pritje_t%C3%AB_Zbatimit_06o717.pdf)

[_Marr%C3%ABveshjet_e_Brukselit_n%C3%AB_Pritje_t%C3%AB_Zbatimit_06o717.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORT_-_Marr%C3%ABveshjet_e_Brukselit_n%C3%AB_Pritje_t%C3%AB_Zbatimit_06o717.pdf).

³Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Rasti Nr. KO130/15. Në dispozicion, në: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/amicus_curiae_brief_ki_shq.pdf.

Dialogu që nuk e solli integrimin real të serbëve, ndihmoi shumë Serbinë, e pak Kosovën, në hapat integruues drejt Bashkimit Evropian. Në strategjinë⁴ e re të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor, Komisioni Evropian ia ofron Serbisë 2023-n si datë të mundshme për anëtarësim, ndërsa për Kosovën theksohet të ketë “një mundësi” për të përparuar në rrugën e saj evropiane “kur këtë ta lejojnë rrethanat objektive”.

Paperspektiva integruese

Kosova është i vetmi shtet në rajon që formalisht nuk e ka nisur rrugën e anëtarësimit në Bashkimit Evropian. Ajo akoma nuk ka aplikuar për të marrë statusin e vendit kandidat. Perspektiva integruese e Kosovës nuk shihet as në Strategjinë e BE-së për zgjerim në Ballkanin Perëndimor, që është publikuar pak para se shteti ta mbushte dekadën e parë. Në këtë dokument të titulluar “Perspektiva kredibile e zgjerimit dhe angazhimi i shtuar i BE-së në Ballkanin Perëndimor”⁵, Kosova përmendet 11 herë.

Në dy raste i komunikohet mundësia për progres të qëndrueshëm nëpërmjet implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për të përparuar në rrugën e saj evropiane, por “kur këtë ta lejojnë rrethanat objektive”. Ndryshe nga kjo, Malit të Zi e Serbisë i saktësohet 2025-a si vit potencial anëtarësimi, Shqipërisë e Maqedonisë mundësia për të hapur negociatat e aderimit, ndërsa Bosnjës e Hercegovinës mundësia për t’u bërë kandidat për aderim.

Në një rast përmendet përfitimi që mund të mbërrijë Kosova në procesin integruues, nëse mbërrin një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht detyruese për normalizimin me Serbinë, në tri raste e njëjta marrëveshje me Kosovën i rikujtohet Serbisë si kusht në procesin e anëtarësimit, dhe në dy të tjera marrëveshja u rikujtohet njëkohshëm të dyja vendeve.

Emri i Kosovës në dy raste të tjera përmendet në kontekst të Dhomave të Specializuara, dhe në një tjetër në fusnotën që shpjegon neutralitetin në raport me statusin.

Mekanizmat e BE-së vejnë fusnotën, për të shpjeguar asteriskun ngjitur emrit të Kosovës, shkaku që pesë vende anëtare ende nuk e kanë njohur pavarësinë. Spanja është midis këtyre vendeve dhe kishte kërkuar që Kosova fare të mos përfshihej në strategjinë e re të zgjerimit dhe në çfarëdo procesi, që lë përshtypjen se trajtohet si shtet⁶.

Por, nuk janë vetëm këto barrierat në procesin integruues. Vet politikanët kosovarë kanë nisur të vetëfajësohen për ngecjen e Kosovës në “vagonin e fundit”, gjatë ecjes së rajonit drejt BE-së. Kjo për shkak se detyrat e shtëpisë nuk i kanë përmbushur.

Marrëveshja për Stabilizim-Asociim përbën aktin kyç në rrugën për integrim në BE. Ky dokument është firmosur mes Kosovës dhe BE-së dhe më 1 prill të vitit 2016 ka hyrë në fuqi. Në shkallë fare të papërfillshme është zbatuar. Në vitin e parë ishin listuar për t’u realizuar 1,374 masa, por kishin përfunduar plotësisht vetëm 762 sish. Nuk ishin zbatuar fiks edhe 612 të tjera. Me “hapa të breshkës” është ecur edhe në vitin vijues. Qeveria nuk i publikoi të dhënat për 2017-n, por Grupi për Studime Juridike dhe Politike gjeti se ishin zbatuar vetëm 34.8 për qind nga 241 masa që duhej zbatuar deri në gjysmën e vitit⁷. Nëse vazhdohet me ritmin e deritashëm, Kosovës do t’i duhet dyfishi i kohës që e ka paraparë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

⁴Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the regions: A credible enlargement perspective for an enhanced EU engagement with the Western Balkans. Në dispozicion, në: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf.

⁵Po aty.

⁶Koha Ditore (30.01.2018): “Ekskluzive: Spanja thotë se Kosova nuk është pjesë e zgjerimit të BE-së”.

⁷RTV21 (2017) “GSJP: Për gjashtë muaj u zbatuan vetëm 34.8 % e masave për MSA-në”. Në dispozicion, në: <http://rtv21.tv/gsjp-per-gjashte-muaj-u-zbatuan-vetem-34-8-e-masave-per-msa-ne/>.

Vitin e shkuar, në 2016-n Agjenda për reforma Evropiane ishte lansuar nga Qeveria e Kosovës dhe nga Bashkimi Evropian. Detyrat e marra për t'i kryer në 2016-n, nuk janë përmbushur as tash kur Kosova ka festuar 10-vjetorin e pavarësisë.

Shteti i kapur

Përgjatë një dekade, Kosova ka qenë një shtet i dobët me pushtet të fortë. Subjektet që e kanë dominuar skenën politike përgjatë kësaj kohe, kanë instaluar kontrollin në të gjitha hallkat, duke i kthyer ato në funksion të interesave të tyre, qoftë individuale a grupore.

PDK-ja ka qenë gjatë gjithë kohës në Qeveri dhe në pjesën më të madhe ka udhëhequr me të. Dalja në publik e përgjimeve të eksponentëve kryesorë të kësaj partie, ka treguar shumë për kontrollin që ajo ka mbi institucionet e pavarura. Në to dëshmohet se si instalohen njerëz në krye të gjykatave e prokurorive, policisë e ndërmarrjeve publike, e madje si diktohen edhe vendimet e Kuvendit.

Subjektet tjera parlamentare, ose kanë qenë në ekzekutiv, ose kanë ushtruar pushtet në nivelin lokal. Pas zgjedhjeve të parakohshme të 2014-s, LDK-ja, AAK-ja, Nisma, e më vonë edhe LVV-ja, u bënë bashkë në një bllok në mësymjen për t'ia mohuar PDK-së që të vazhdonte të qeveriste, ndonëse kishte dalë e para në zgjedhje. I këtillë bashkim arsyeohej me nevojën për "heqjen e PDK-së nga kapja e shtetit"⁸. LDK-ja që ndarë nga blloku dhe vendosi të bashkëqeveriste me PDK-në, por me marrëveshjen e koalicionit shprehej përcaktimit të vazhdohej politika e kapjes. Neni i 8 i saj saktësonte ndarjen e barabartë të të gjitha pozitave "të cilat janë të themeluara nga Qeveria dhe Kuvendi". Në zgjedhjet pasuese, PDK-së iu bashkua AAK e Nisma dhe as ato nuk dhanë sinjale se janë të interesuara t'i "çlirojnë" institucionet e pavarura. Qeveria e drejtuar nga kreu i AAK-së, një nga vendimet e para që mori, ishte shkarkimi i anëtarëve të bordit të Agjencisë së Akreditimit, pas të cilit vendim Agjencia u përjashtua nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Vetëvendosja aktualisht është subjekti me më së shumti deputetë në Kuvend, por kurrë nuk ka qeverisur në nivel qendror. Tash ajo qeveris në tre komuna, përfshirë Prishtinën, ku, një nga vendimet e para pas zgjedhjeve të fundit, ka qenë marrja e kontrollit mbi ndërmarrjet publike komunale⁹.

Raporte kredibile kanë konstatuar kontrollin që pushteti e ka shtrirë nëpër institucione. Në vijim ndodhen disa nga gjetjet që përmban raporti¹⁰ i fundit që Komisioni Evropian e nxjerr për Kosovën: "Gjyqësori është ende i cenueshëm ndaj ndikimeve politike"; "Ndikimi i tepruar gjatë hetimeve ... pengon luftën kundër krimit të organizuar"; "Efikasiteti i hetimeve vazhdon të pengohet nga ndikimi politik"; "Ndikimi i tepruar dhe kapaciteti i kufizuar ende pengojnë kryerjen efektive të hetimeve financiare"; "RTK është direkt i financuar nga shteti, gjë që ... e lë të rrezikuar ndaj ndikimit politik"; "Ndikimi politik rreth emërimeve dhe shkarkimeve (të zyrtarëve civilë v.j.) vazhdon të jetë një shqetësim serioz, sidomos në zgjedhjen e menaxhmentit të lartë"; "Procedurat e emërimeve të menaxhmentit të ndërmarrjeve publike janë shpesh subjekt i ndikimit politik", "Arsimi mbetet një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik, veçanërisht arsimi i lartë".

⁸Radio Evropa e Lirë (2017) "Drejt marrëveshjes për koalicion". Në dispozicion, në: <https://www.evropaelire.org/a/25444409.html>.

⁹Kallxo.com (2017) "Vetëvendosje Merr Kontrollin e Ndërmarrjeve Publike në Prishtinë". Në dispozicion, në: <http://kallxo.com/vetevendosje-merr-kontrollin-e-ndermarrjeve-publike-ne-prishtine/>.

¹⁰Komisioni Evropian, "Raporti i vitit 2016 për Kosovën*". Në dispozicion, në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf.

Kjo varësi ka bërë që të mos ketë as funksionim dhe menaxhim efikas të këtyre organeve, të cilat vetëm në emërtim janë të pavarura.

Kaosi institucional

Spektri politik nuk e ka vazhduar traditën e krijuar para shpalljes së pavarësisë, në lidhje me përmbylljen e plotë të mandateve të institucioneve. Në dekadën e fundit, në Kosovë janë organizuar tri palë zgjedhje të nivelit qendror, që të gjitha të parakohshme. Katër presidentë kanë qenë në këtë periudhë, dhe vetëm njëri ka mbërritur ta çojë në fund mandatin. Kaosi nuk lidhet vetëm me këto zhvillime, por edhe me ngërçin e gjatë politik të krijuar pas dy palë zgjedhesh, si dhe me sjelljen jodemokratike që opozita e ka demonstruar në mandatin e shkuar në Kuvend.

Fatmir Sejdiu u detyrua të largohej nga pozita e presidentit, pasi Gjykata Kushtetuese gjeti se ai po shkelte Kushtetutën duke udhëhequr shtetin dhe njëkohshëm duke ushtruar funksionin e kryetarit në një subjekt politik, përkatësisht në LDK. Pasuesi i Sejdiut, Behgjet Pacolli, mundi të qëndrojë në majë të shtetit për vetëm një muaj. Kjo për shkak se e njëjta gjykatë konsideroi se zgjedhja e tij ishte jokushtetuese, nga shkak që në dy raundet e para procesi i votimit ishte zhvilluar nga Kuvendi, edhe pse në sallë nuk ishin 80 deputetë, sa ishte minimumi i votave pro, me të cilat mund të zgjidhej kreu i shtetit. Kushtetuesja u bë mburojë për presidenten Atifete Jahjaga që erdhi pas Pacollit, nëpërmjet një marrëveshje, sipas së cilës ajo do ta udhëhiqte shtetin derisa të bëheshin ndryshimet kushtetuese në funksion të zgjedhjes së presidentit drejtpërdrejt nga populli. Gjykata konstatoi se me amendament nuk mund t'i ndërpritej presidentit mandati dhe se normat e reja mund të vlenin vetëm pas përfundimit të mandatit të rregullt. Hashim Thaçi e ka pasuar Jahjagën në post, dhe deri në këtë moment është në atë funksion.

Përgjatë dhjetë viteve, akoma më dramatike kanë qenë zhvillimet në Qeveri e Kuvend. Dy mandatet qeverisëse të Hashim Thaçit dhe një i Isa Mustafës kanë përfunduar me mocion. Vetëm pas zgjedhjeve të para të organizuara në shtetin e pavarur, e që ishin të parakohshme, Kosova nuk ka përjetuar ngërç politik. Në dy të tjerat po.

Zgjedhjet e qershorit të 2014-s prodhuan një bllok pas zgjedhor. LDK, AAK e Nisma, të ndihmuara edhe nga LVV-ja, u bënë bashkë në mësymjen për ta larguar nga pushteti PDK-në e Thaçit. Ky bllok konsideronte se e kishte shumicën në Kuvend dhe mund t'i formonte institucionet, ani se PDK-ja kishte dalë e para. Ideal i mbajti të bashkuara subjektet vetëm deri në momentin kur Gjykata Kushtetuese e shpalli të pavlefshëm zgjedhjen e Isa Mustafës për kryeparlamentar. Pas rreth 6 muajsh bllokadë, LDK lidhi koalicion me PDK-në, marrëveshje që Mustafën e bëri kryeministër e Thaçin presidenti.

Në atë mandat, Kuvendi përjetoi përplasje më të mëdha. Opozita e përbërë nga LVV, AAK e Nisma funksionoi në bllok për të kundërshtuar Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi dhe një marrëveshje për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe. Kauzat u mbrojtën duke mos zgjedhur mjete kundërshtimi – përdorën gaz lotsjellës në Kuvend dhe organizuan protesta masive në sheshet e kryeqytetit, disa nga të cilat edhe të dhunshme. Përgjatë kësaj kohe është sulmuar me predhë edhe Kuvendi, për të cilin sulm, autoritetet akuzuan pesë aktivistë të LVV-së, njëri nga të cilët është gjetur i vdekur gjatë paraburgimit, kurse katër të tjerë janë dënuar në shkallë të parë për terrorizëm, por vendimi është apeluar dhe rasti është kthyer në rigjykim.

Vitin e shkuar, PDK-ja bëri votat bashkë me opozitën, në mocionin kundër qeverisë Mustafa, së cilës i përkiste. Në zgjedhjet që pasuan, ajo mori në koalicion parazgjedhor AAK-në e Nismën, të cilat kishin ndarë rrugët me LVV-në derisa ishin në opozitë. Ndonëse koalicioni doli si subjekt i

parë, me minoritetet nuk mund ta bënte shumicë. Prandaj, pas disa muaj bllokade, mbërriti t'i "peshkonte" tre nga katër deputetët e AKR-së që ishin në koalicion parazgjedhor me LDK-në. Gjatë një dekade, nuk pati një temë për të cilën i gjithë spektri politik zhvilloi konsultime mes vete dhe doli me zgjidhje të përbashkët. Për asnjë çështje nuk pati konsensus.

Vendnumërimi ekonomik

Kosova ka dalë nga lufta me një ekonomi të shkatërruar, është pavarësuar pa ndonjë përparim të ndjeshëm dhe në ngecje ka mbushur dekadën e parë të shtetësisë. Ka ngelur kampion në Evropë për kah varfëria dhe shkalla e papunësisë. Më shumë se fjalët, në ekonomi flasin shifrat. Disa më kryesore janë përshkruar në vijim.

Dekada e parë është përmbyllur me rritje vjetore prej 3.9 për qind, ndryshe nga nevoja, planifikimi e premtimi shumë më i lartë. Kjo rritje e pamjaftueshme vjetore ka qenë thuajse e njëtrajtshme përgjatë gjithë dekadës dhe në të kontribuues më të mëdhenj kanë qenë konsumi dhe investimet, por jo edhe eksporti që ka ngelur i ulët. Me këtë ritëm rritjeje, sipas Bankës Botërore, Kosovës do t'i duhen deri në gjashtë dekada, në mënyrë që nivelet e të ardhurave të kapin ato të Bashkimit Evropian¹¹.

Efektet e këtij vendnumërimi më së qarti shihen në shkallën e papunësisë, që është më e larta në Evropë. Në tremujorin e tretë të 2017, sipas Agjencisë së Statistikave, shkalla e punësimit ka qenë 30.4 për qind, rreth 4.2 për qind më shumë krahasuar me 2008-n. Raporti i fundit tregon se shkalla e papunësisë është 30.2 për qind, ndërsa shkalla e jo aktivitetit 56.5 për qind. Niveli më i theksuar i papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare, me 53.3 për qind. Numri i vendeve neto të punës për dhjetë vite ka qenë vetëm 63 mijë, ndryshe nga fakti se, në secilin vit, tregut të punës i shtohen rreth 25-30 mijë të rinj.

Por, shifrat nuk tregojnë se gjendja mund të ndërrojë. Deficiti tregtar vetëm sa është thelluar. Ka qenë 1.8 miliardë euro në vitin e pavarësisë, ndërsa ka degraduar në diku 2.5 miliardë euro në 2017-n. Rreth gjysma e eksporteve të Kosovës janë hekurishtat, kurse pjesa tjetër kryesisht materialet e papërpunuara dhe produktet me bazë metalike.

Banka Botërore në raportin e "Të bërit biznes 2018", Kosovën e ka listuar në mesin e 10 ekonomive të mbarë botës që ka pasur përmirësimin më të madh. Është në pozitën e 40 nga 190 vende sa i përket lehtësisë së të bërit biznes. Mirëpo, ky dhe të tjerë janë vetëm rangime simbolik. Në realitet, investimet e huaja kanë mbetur në nivel minimal dhe nuk ka pasur as fluks të rritjes së bizneseve nga vendësit. Ato kryesisht janë bazuar në derdhjen e kapitalit të diasporës në Kosovë. Në 2008-n bilanci vjetor i investimeve direkte ishte 370 milionë euro, kurse në 2016-n gati se është përgjysmuar – ishte 220 milionë euro¹². Pengesat kryesore për investime, sipas Komisionit Evropian, përfshinin administratën e dobët dhe të papërgjegjshme, infrastrukturën e pazhvilluar, sundimin e dobët të ligjit, korrupsionin, ekonominë e përhapur joformale dhe rezultatet e dobëta të arsimit.

Privatizimi që s'prodhoi zhvillim

Ekonomia doli e shkatërruar nga lufta, pas së cilës administrata ndërkombëtare që u vendos në Kosovë, i mori në administrim mbi 500 ndërmarrje shoqërore dhe i vuri në privatizim, me synimin

¹¹Radio Evropa e Lirë (2017) "Me trendin e rritjes ekonomike, Kosova 60 vjet larg vendeve të BE-së". Në dispozicion, në: <https://www.evropaelire.org/a/rritja-ekonomike-kosova-60vjet-larg-be/28891921.html>.

¹²Banka Qendrore e Kosovës "Investimet e huaja direkte". Në dispozicion, në: <https://www.bqk-kos.org/?id=55>.

për t'i përmbushur dy qëllime që i kishte vendosur: rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik. Qëllimet nuk ishin mbërritur as në 2008-n kur Kosova është pavarësuar dhe kompetenca e privatizimit kaloi tek vendorët, por as edhe një dekadë më vonë.

Kosova vazhdon ta ketë ekonominë më të dobët në Evropë dhe vuan nga një normë e ulët zhvillimi. Rritja e pamjaftueshme në raport me nevojat ka bërë që vendi të mbetet kampion edhe për kah shkalla e lartë e papunësisë. Politikat liberale në raport me ekonominë socialiste të trashëguar nga paraluftra, nuk dhanë rezultatet që pritëshin. Shitja e ndërmarrjeve nuk i shpëtoi ato nga degradimi. Efektet ishin e kundërta e asaj që pritej. Këtë e dëshmojnë dy gjetje që përmban një raport¹³ studimi, i realizuar nga "Forum 2015", pas privatizimit të pjesës më të madhe të ndërmarrjeve: 1. Në kohën e realizimit të studimit, nuk funksiononin 31 për qind e 103 ndërmarrjeve të privatizuara që ishin pjesë e mostrës; 2. Përpos ndikimit negativ në punësim që kishin ndërmarrjet të cilat nuk funksiononin, niveli i punësimit kishte rënë edhe te ato aktive.

Nga viti 2002 e deri në 2016-n, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe pararendësja e saj e dominuar nga ndërkombëtarët, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, kanë administruar ose kërkonin të administronin me gjithsej 3,324 asete të ndërmarrjeve shoqërore, përfshirë edhe ato që shteti i ka jashtë territorit të saj. Janë 1,483 shitje të realizuara deri tash, nga të cilat fondi i grumbullimit ka mbërritur vlerën prej 684,772,221 eurosh. Këto mjete janë afërsisht sa gjysma e buxhetit vjetor të shtetit, por kurrë nuk janë vënë në funksion të aktivitetit ekonomik. Ato mbahen të ngrira në Bankën Qendrore. Ndërkombëtarët kishin normuar mbajtjen bllokuar të mjeteve të privatizimit dhe ishin kritikuar rreptë nga vendorët, por këta të fundit nuk e ndryshuan qasjen edhe pse prej një dekade kanë autoritetet të vendosin vet për fondin.

Në procesin e privatizimit, storie suksesi treguan fare pak ndërmarrje. Disa u transformuan e shumë mbetën të mbyllura. Jo pak sosh u vlerësua të ishin shitur për çmime banale, e pronarë të të cilave ishin bërë njerëz të fuqishëm të politikës ose të afërm me ta, si dhe njerëz të grupeve të ndryshme të interesit. Mbi disa procese të mëdha janë ngritur pretendime për ndikime politike dhe për korrupsion. Rasti më i rëndë ishte në 2012-n kur Bordi i Agjencisë vendos për tërheqje të aksioneve të Grandt, hotel që ndodhet në qendër të Prishtinës. Në mesin e aksionarëve që kishin futur kapital për blerje të hotelit, ishte zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli. Aksionarët hodhën akuza publike, sipas të cilave zëvendësministri i Financave i asaj kohe, Astrit Haraqija, kishte luajtur rolin e sekserit në atë rast dhe, në emër të kryetarit të Bordit të AKP-së, Dino Asanaj, kishte kërkuar 4 milionë euro si kusht që aksionet të mos tërhiqeshin. Në muajin pasues, Asanaj ishte gjetur i vdekur në zyrën e tij private. Vdekja ishte pasojë e disa therjeve me thikë, e për të cilat autopsia ka thënë të jenë vetëshkaktuar, prandaj rasti është kualifikuar si vetëvrasje.

Jo pak asete shoqërore për gati dy dekada u lanë në duar të uzurpatorëve. Në vitin 2014 numri i tyre ishte 491.

Korrupsioni si sëmundje

Me term mjekësor ka folur Komisioni Evropian, kur në 2015-n përmendi shkallën e korrupsionit në Kosovë. Në raportin periodik vjetor, theksoi se kjo përbënte një "endemi", shprehje e cila i referohet një sëmundjeje që ka përfshirë së paku një të dhjetën e një popullimi.

Raporti i 2008-s alarmoi se korrupsioni ishte i përhapur dhe mbetej problem kryesor në Kosovë. E tillë situatë ishte për shkak të mungesës së masave legjislative dhe implementuese dhe mungesës së vendosmërisë dhe dobësisë së sistemit gjyqësor. "Endemia" nuk është luftuar

¹³Forum 2015 (2008) "Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë: Një gotë gjysmë bosh dhe gjysmë e plotë?". Në dispozicion, në: <http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476702103.pdf>.

përgjatë një dekade. Raporti i fundit, ai i 2016-s, gjen se korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Po atë vit, nga 42 vende pjesëmarrëse në Barometrin Botëror të Korrupsionit TI 2016¹⁴, Kosova zuri vendin e tretë me 65 për qind.

“Sëmundja” ka përfshirë thuajse të gjitha hallkat e shtetit. Sipas një studimi¹⁵ të UNDP-së, i nxjerrë në 2016-n, kosovarët i shohin si sektorët më të korrumpuar partitë politike, Kuvendin e Kosovës dhe institucionet e nivelit qendror, pasuar nga gjyqësori, shërbimet shëndetësore dhe institucionet e nivelit lokal.

Prokurimi publik gjatë gjithë dhjetëvjetëshit të fundit ka përbërë njërin prej burimeve më të mëdha të korrupsionit. Shumë denoncime në publik janë bërë për afëra korruptive dhe ka pasur edhe hetime për disa zyrtarë të lartë shtetërorë, përfshirë ministra që ishin nën akuzë që në 2010-n. Por, jo shumë raste kanë përfunduar me dënime të formës së prerë.

Ka shumë vepra në lidhje me korrupsionin që përfshijnë anëtarët e sistemit të drejtësisë dhe se efikasiteti i hetimeve dhe gjykimeve vazhdon të pengohet nga ndikimi politik. Disa afëra të zbuluara përgjatë dekadës, veçmas ajo “Pronto”, kanë dëshmuar ndërhyrjen e autoriteteve në gjyqësor, qoftë duke vendosur njerëz të dëgjueshëm në organin e akuzës dhe në gjykata, qoftë duke diktuar vendimmarrjen.

Ka disa pasoja të mëdha që shteti ka përjetuar shkaku i mungesës së luftës ndaj kësaj dukurie. Vet Qeveria e ka pranuar se korrupsioni është duke e mbajtur peng rritjen ekonomike. Në fund të 2016-s, Korporata Sfidat e Mijëvjeçarit e ka përjashtuar Kosovën nga programi “Compact”, që ofronte mundësinë e thithjes së qindra milionë dollarëve amerikanë brenda pesë vitesh. Për të njëjtën arsye, Kosova ka mbetur enklavë në hartën e Evropës – mungesa e rezultateve për ta luftuar korrupsionin në nivelin e lartë është një nga dy arsytet pse BE-ja ende nuk e ka hequr regjimin e vizave. Në përgjithësi, “korrupsioni endemik” ka përbërë barrierë për shtetin, si në rrugën për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, po kështu edhe politik e social.

Lufta me geton

Kosovarët bëjnë jetë në geto, meqë shteti i tyre është “enklavë” në hartën e Evropës. Ata janë të privuar nga lëvizja e lirë në zonën Schengen, por, përgjatë një dekade, duke përdorur rrugë ilegale, kanë mundur të mbërrijnë në të rreth 10-përqindëshi i të gjithë banorëve rezidentë sa ka shteti i ri.

Valët e ikjes nuk u kanë shpëtuar tragjedi. Në vitin e dytë të shtetësisë së Kosovës, 15 qytetarë të saj kishin humbur jetën kur ishte përmbatur barka me të cilën po lundronin në lumin Tisa, në një lokalitet në kufirin Serbi-Hungari. Ata gjetën vdekjen, në përpjekjen që, nëpërmjet rrugëve ilegale, ta braktisnin shtetin me ekonominë më të varfër në Evropë. Prej atëherë e deri në 2017-n, llogaritet të kenë kërkuar azil në vendet e BE-së mbi 190 mijë kosovarë.

Ikja më masive e qytetarëve të Kosovës ka ndodhur në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015. Mundësi të vetme për ta shpërthyer izolimin, kishin parë migrimin në rrugë ilegale. Kjo për shkak se pasaporta e tyre është ndër më me pak vlerë në gjithë botën. Sipas kompanisë “Henley Passport Index”, e cila bën studime periodike për fuqinë e pasaportave të shteteve, ajo e Kosovës

¹⁴TransparencyInternational, “Global corruptionbarometer – Peopleandcorruption: Europeand Central Asia” (2016). Në dispozicion, në: http://www.transparency.org/ehatëedo/publication/people_and_corruption_europe_and_central_asia_2016.

¹⁵UNDP, “Pulsi publik mbi korrupsionin” (2016). Në dispozicion, në: http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/special-edition-of-the-public-pulse-on-corruption.html.

listohet e 97-a, fare pak përpara pasaportës së Afganistanit që listohet e fundit dhe mban renditjen 105¹⁶.

Qytetarët e Kosovës mbeten të izoluar meqë lëvizja në zonën Schengen ka mbetur peng i dy detyrave të papërmbushura nga ana e autoriteteve vendëse.

Në qershor të 2012-s, Komisioni Evropian ia dorëzoi Kosovës Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Dokumenti përmbante 94 kritere dhe organizohej në katër blloqe. Në maj të vitit 2016, Komisioni rekomandoi që Kosovës t'i hiqej regjimi i vizave, por kishte një kusht – deri në mbledhjen e Parlamentit Evropian, që parashihej të mbahej pas disa kohësh, Kosova duhej të plotësonte dy detyrat e mbetura: Të ratifikonte Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi dhe të jepte prova se po luftohej korrupsioni në nivel të lartë, sipas një regjistri rastesh që BE-ja i monitoron. Ky ishte një moment kur në Prishtinë politikanët ia kishin hequr tapën shampanjës dhe po e festonin “arritjen”.

Por, prej dy vitesh, dy “detyrat e shtëpisë” nuk u kryen.

Demarkacioni ka qenë një nga dy çështjet për të cilat, në mandatin e shkuar, koalicioni qeverisës dhe opozita kanë zhvilluar përplasjen më të rreptë që prej kur Kosova është çliruar nga Serbia. Opozita konsideronte se me të Kosova humbte rreth 8 mijë hektarë, prandaj me gaz lotsjellës brenda Kuvendit e me protesta jashtë, ka penguar secilën përpjekje për ta ratifikuar marrëveshjen. Tek në prag të jubileut të shpalljes së pavarësisë, dy nga partitë që në mandatin e shkuar ishin në opozitë, por tash në pushtet, AAK e Nisma, kanë pranuar të votojnë pro, pas një deklaratë të përbashkët mes presidentit të Kosovës dhe atij të Malit të Zi, në të cilën shprehet gatishmëria që marrëveshja të korrigjohet në rast se dalin fakte të reja ligjore. Iniciativa për një deklaratë të tillë ishte marrë edhe në mandatin e shkuar, por opozita nuk e pranonte asnjë modalitet, përpos ratifikimit të marrëveshjes së “korrigjuar”.

Në anën tjetër, autoritetet nuk kanë treguar vendosmëri për ta luftuar korrupsionin, veçmas në nivel të lartë. Autoritetet evropiane kërkojnë rezultate në një të hetimeve dhe aktgjykimeve finale të gjykatave lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë trafikimin me narkotikë, trafikimin me qenie njerëzore dhe shpëlarje të parave. Ato nuk janë parë deri tash. Pasojat janë shumëdimensionale. Më të prekurit konsiderohen të rinjtë, të cilët në shumë raste privohen nga mobiliteti dhe nga e drejta për një shkollim më cilësor që ofrohet jashtë vendit. Po kështu, edhe kategori të tjera specifike nga bota akademike, biznesi, kultura e sporti.

Procedurat aktuale për t'u pajisur me viza marrin kohë deri në disa muaj. Bazuar në statistikat zyrtare të Komisionit Evropian¹⁷ për vitet 2010-2012, ambasada e Belgjikës, Gjermanisë, Greqisë, Finlandës, Hungarisë, Italisë, Sllovenisë, Zvicrës dhe Norvegjisë kishin lëshuar viza Schengen për qytetarët e Kosovës. Në total, për tri vite ishin parashtruar 217.862 aplikime për vizë. Të tri vitet në total përbëjnë afër 37.500 aplikime të refuzuara. Vetëm për këto tri vite, kosovarët kanë shpenzuar rreth 15 milion euro, prej të cilave 9 milionë euro janë shpenzuar për pagesë direkte për vizat në ambasada, kurse së paku 5.8 milion euro janë shpenzime tjera të ndërlydhura me kompletimin e dokumentacionit për vizë, shpenzimet bankare dhe ato të rrugës¹⁸.

¹⁶Koha.Net (2018) “Pasaportat më të fuqishme në botë kanë Singapori e Japonia – Kosova e 97-ta”. Në dispozicion, në: <http://www.koha.net/arberi/78231/pasaportat-me-te-fuqishme-ne-bote-kane-singapori-e-japonia-ndash-kosova-e-97-ta/>.

¹⁷Instituti GAP & Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2013) “Ekonomia e Vizave: Raport mbi koston e vizave për kosovarët për periudhën 2010-2012”. Në dispozicion, në: http://www.institutigap.org/documents/55950_Raport_mbi_koston_e_vizave_per_kosovaret_per_periudhen_2010-2012.pdf.

¹⁸Po aty.

Arsimi ngelet në provim

Nuk e kanë dhënë “provimin” politikat që shteti i ka aplikuar në arsim, përgjatë një dekade. Testimi i bërë në 2015-n në kuadër të Programit Ndërkombëtar të Vlerësimit të Nxënësve (PISA), e ka renditur Kosovën në fund të listës së 70 shteteve pjesëmarrëse, duke lënë pas vetëm Algjerinë dhe Republikën Dominikane.

Ka gjashtë nivele në të cilat rangohen rezultatet e PISA-s. Për aftësitë minimale të nxënësve flet niveli i dytë. Rezultatet treguan se në fushën e të kuptuarit të leximit, 77 për qind e nxënësve kosovarë nuk i kanë treguar aftësitë minimale, në fushën e matematikës 78 për qind, e në atë të shkencave 68 për qind.

Ky rezultat është pasojë e një sistemi në të cilin është eksperimentuar vazhdimisht me kurrikulë, dhe i cili ka qenë i paaftë për t'i pajisur nxënësit me kompetencë të avancuar të komunikimit e të shprehur, sikurse as nuk ua ka zhvilluar kompetencën e mendimit kritik. Shprehitë e para krijohen në vitet e hershme, por arsimi parafillor është lënë jashtë prioriteteve – në vitet e fundit, vetëm rreth 4 për qind e fëmijëve të moshave 0-5 vjet kanë ndjekur këtë nivel shkollimi.

Shpenzimet për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm, kanë qenë më të ulëta se të disa vendeve fqinje, ndërkaq 75 për qind e shpenzimeve të përgjithshme kanë shkuar për rroga. Investimet, edhe ato të pamjaftueshme, janë përqendruar kryesisht në infrastrukturë. Fëmijët e nivelit fillor e të nivelit të mesëm të ultë i siguroar tekstet shkollore gratis nga shteti, por në një numër rastesh, ato posedonin pasaktësi shkencore e promovonin stereotipet gjinore. Mësimdhënësit, ndërkaq, nuk ishin mjaftueshëm të trajnuar për të zbatuar kurrikulat që ndërroreshin.

Arsimi universitar është karakterizuar nga ndërhyrje politike. Përgjatë dekadës së fundit, tre rektorë në universitetin më të madh publik në Kosovë, kanë qenë njerëz që në momentin e marrjes së postit kishin funksione në parti politike. Të tillë janë vënë edhe në krye të disa prej 6 universiteteve të reja publike që janë hapur në 10 vitet e fundit. Pasojat e ndërhyrjeve politike në institucionet e arsimit bën që Agjencia e Akreditimit, këtë vit, të përjashtohet nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Qeveritë kanë aplikuar politika të mbipopullimit të universiteteve me studentë, me synimin për ta ruajtur paqen sociale. Thuajse për secilin prej rreth 30 mijë maturantëve që për secilin vit kryente shkollën e mesme, ka pasur një vend, qoftë në universitete publike, qoftë në rreth 30 kolegje e institute private, disa nga të cilat për vite kanë funksionuar pa licencë e akreditim. As kjo politikë e mbingarkesës me studentë, nuk është përcjellë me rritje përkatëse të mjeteve financiare, investimeve në infrastrukturë e shkencë, apo për të mbështetur rritjen e numrit të mësimdhënësve. Kuadri akademik në jo pak raste është graduar në kundërshtim me normat që kërkonin kredencialet e nevojshme shkencore.

Politika e demonstruar ka krijuar hendek në mes të mungesës së kuadrove dhe hiperprodhimit të të diplomuarve. Kjo ishte pasojë e programeve të studimit dhe e politikave të regjistrimit që nuk i përshtateshin nevojave të tregut të punës dhe as nuk i bënin studentët të zotë të profesionit për të cilin diplomoheshin.

Një problem tjetër që ka përcjellë arsimin është mungesa e një sistemi unik në të gjithë vendin. Nxënësit serbë vijojnë shkollat që financohen dhe menaxhohen nga Ministria e Arsimit e Serbisë, dhe në to nuk ka kontroll Kosova, edhe pse ndan buxhet për pagat e mësimdhënësve. Situatë e njëjtë është edhe në arsimin e lartë, por së fundmi shteti ka njohur diplomat e marra në universitete serbe që nuk i janë nënshtruar licencimit e akreditimit të mekanizmave të Kosovës.

Shëndetësia pa diagnozë e terapi

As diagnozë dhe as terapi nuk është gjetur për sistemin shëndetësor në Kosovë. Cilësia e shërbimeve ka njohur fare pak përparim, që prej pasluftës.

Institucionet e nivelit primar, sekondar e terciar janë zhvilluar jomjaftueshëm, ndërsa politikat qeveritare nuk kanë ofruar mbështetjen e nevojshme për to. Qeveria, në Strategjinë¹⁹e fundit të shëndetësisë, ka theksuar të mos jetë e mundur që me buxhetin i cili është në dispozicion për institucionet shëndetësore të ofrohen stimulime për përmirësim të performancës, duke dhënë mesazh kështu që gjendja pak ka gjasë të përmirësohet. Edhe resurset në dispozicion për shërbimet shëndetësore publike, janë më të ulëtat në Evropë.

Shteti nuk ka nisur ende mbledhjen e premieeve për të mbushur Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, i themeluar që në 2014-n me ligj. Për pasojë, kosovarët kanë mbetur të vetmit qytetarë në rajon që nuk kanë sigurime shëndetësore. Edhe sikur premiumet të fillonin të mblihdeshin, nuk janë finalizuar të gjithë parakushtet për nisjen e aplikimit të politikës së re. Një nga pengesat është Sistemi i Informimit Shëndetësor me historitë mjekësore të pacientëve, i cili nuk është funksionalizuar, edhe pse ka filluar prej vitesh. Ai ka mbulueshmëri vetëm në një të tretën e territorit të shtetit.

Shumë raporte kredibile vendore e ndërkombëtare kanë treguar se korrupsioni është shumë i pranishëm dhe paraqet sfida serioze për shërbimet e kujdesit shëndetësor. Format e korrupsionit janë të lidhura me caktimin e terminëve për operime dhe orare diagnostike e trajtime të tjera, por edhe me lidhjen që mjekët e institucioneve publike kanë me ato private, dhe kompensimin që sigurojnë për secilin pacient që e referojnë tek to. Në qershor të 2016-s, 62 persona u akuzuan nga ana e prokurorisë për vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar, ushtrimin e paligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe trajtimin e pandërgjegjshëm mjekësor. Raportime për abuzime me detyrën, janë të shpeshta.

Dy janë pasojat më të mëdha të kësaj situate: Përpos kualitetit më të dobët të jetës, kosovarët kanë jetëgjatësi për 5 vjet më të ulët se shtetasit e vendeve të rajonit, e 10 vjet më të ulët sesa ata të vendeve të BE-së; Kosovarët shpenzojnë prej 120 milionë euro deri në 150 milionë euro në vit për trajtime mjekësore jashtë vendit²⁰, në të cilën shifër përfshihen trajtimi dhe shpenzimet për udhëtim e qëndrim jashtë.

Një nga problemet që e ka përcjellë sektorin, ka të bëjë me listën esenciale të barërave, e cila përmban medikamentet që shteti i siguron nëpërmjet procedurave të prokurimit dhe i shpërndan falas. Shpesh, institucionet shëndetësore mbeten pa të tilla, ndërsa jo në pak raste është raportuar për abuzime në procesin e kontraktimit të tyre, meqë disa herë janë blerë me çmime shumë më të larta se të tregut. Ka pasur edhe raste kur barërat e listës esenciale të siguruar nga Qeveria, kanë përfunduar për shitje në barnatore private.

Një problem tjetër, është ikja e mjekëve. Shumë të diplomuar, por edhe specialistë, përzgjedhin të shkojnë në vendet e Evropës, e veçmas në Gjermani, ku u ofrohet mundësia e zgjedhjes së specializimit dhe një pagë shumëfish më e lartë se në Kosovë. Sindikalistët shëndetësorë kanë alarmuar se trendi nuk është i mirë. Federata Sindikale ka bërë një anketë me 1 mijë studentë të mjekësisë, 73 për qind prej të cilëve kanë deklaruar se do të ikin jashtë vendit²¹

¹⁹Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021 (2016). Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB_.pdf.

²⁰Shifra rreth shpenzimeve për shërim jashtë vendit kanë dhënë në paraqitje publike zyrtarët e Federatës Sindikale. Një nga to ndodhet në dispozicion, në: <https://telegrafi.com/qytetaret-shpenzojne-rreth-150-milione-euro-ne-vit-per-sherim-jashte-kosoves/>.

²¹Zeri.info (2015) "Ikja e mjekëve nga Kosova, shqetësuese". Në dispozicion, në: <http://zeri.info/aktuale/20890/ikja-e-mjekeve-nga-kosova-shqetesuese/>.

Lindja e shtetit

Kosova e ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt të 2008-s, rreth një vit pasi Martti Ahtisaari, i dërguar i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e statusit të Kosovës, finalizoi Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin²². Dokumenti u nxor pas negociatave të vështira ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nën ndërmjetësimin e Ahtisaarit, proces ky i nisur në korrik të 2016-s në Vjenë.

Propozimi nuk qe pranuar nga Serbia, ndërkaq ekipi që përfaqësonte Kosovën në negociata, ishte dakorduar të merrte përgjegjësitë e përcaktuara në dokument. Edhe një proces tjetër plotësues i negociatave do të rridhte para momentit historik. Me insistimin e Ruisë dhe pajtimin e vendeve të Quint-it, u vendos për tre muaj bisedime shtesë, nën udhëheqjen e treshes: përfaqësuesit të BE-së, Wolfgang Ischinger, atij amerikan Frank Wisner dhe rusit Alexander Botsan-Kharchenko. As ky nuk dha ndonjë rezultat.

Propozimi i Ahtisaarit nuk ishte vënë para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilin forum e ka të drejtën e vetos Federata Ruse, mbështetësja më e madhe e Serbisë. Pas kësaj rrethane, në koordinim me partnerët strategjikë të Kosovës – Shtetet e Bashkuara dhe vendet më të fuqishme të Bashkimit Evropian – në një seancë solemne, udhëheqësit e popullit – Presidenti, anëtarët e Kuvendit dhe anëtarët e Qeverisë – nëpërmjet një Deklarate kanë shpallur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Që në pikën e parë të deklaratës theksohet se kjo shpallje “është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”²³. Dispozitat që përmban Plani Ahtisaari, veçmas ato që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve pakicë, u përfshinë në akte juridike të shtetit të ri – në Kushtetutë e në Ligje.

Realiteti i ri ishte marrë në konsideratë edhe nga OKB-ja dhe nga BE-ja. E para kishte tkurrur misionin e vet në Kosovë, ndërkaq shumë nga kompetencat i ishin kaluar Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar që për mision kishte mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë, e të tjera ishin bartur tek EULEX-i, mision evropian për sundim të rendit e të ligjit, që akoma është aktiv.

Nga brenda, ky zhvillim është pasuar me një numër veprimesh në dy rrafshë: Në konsolidimin e shtetit dhe në sigurimin e njohjeve ndërkombëtare të pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës. Në vitin e saj historik, Kosova u bë edhe me Kushtetutë, në hartimin e së cilës morën pjesë ekspertë vendës e ndërkombëtarë. Akti më i lartë juridik i shtetit u miratua në prill nga legjislativi dhe hyri në fuqi pas dy muajsh. Legjislacioni, po kështu, i është nënshtruar ndryshimeve.

Të njëjtën ditë kur është shpallur pavarësia, Kuvendi miraton flamurin, kurse rreth katër muaj më vonë edhe himnin e Republikës, i titulluar “Evropa”, por i cili nuk ka një tekst. Në pikat kufitare, Qeveria vendos pllakatat me mbishkrimin “Republika e Kosovës” dhe për simbolikë të parën e vë në Merdare, në pikëkalimin me Serbinë.

Pa u mbushur viti i parë, nisë misionin e saj Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila ishte propozuar me Planin Ahtisaari, por pa mandat ushtrie. Vetëm 1,400 prej 3,000 pjesëtarëve aktivë sa kishin Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, arritën të kalonin suksesshëm testet e përpiluara nga NATO. Megjithëkëtë, Forca e Sigurisë akoma nuk ka marrë mandat ushtrie.

²² Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (2007). Në dispozicion, në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf>.

²³ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës (2008). Në dispozicion, në: https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Dek_Pav_sh.pdf.

Një kërkesë për njohje të shtetësisë Kosova e kishte nisur tek burrështetasit e të gjitha vendeve të globit. Disa përgjigje pozitive mori menjëherë. Brenda 24-orëshit të parë, shtetësia iu njoh nga Mbretëria e Bashkuar, Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia, Shqipëria, Afganistani dhe Kostarika. Brenda vitit të parë, sigurohen 54 njohje, ndërsa deri në dekadën e parë shteti ka mundur vetëm ta dyfishojë këtë numër. Ishin vënë edhe marrëdhënie diplomatike. Zyra ndërlidhëse e Shteteve të Bashkuara e avancoi menjëherë statusin në ambasadë dhe veprimi pasohet nga shumë shtete të tjera. Në anën tjetër, në vitin e parë të saj si shtet, Kosova nominon 10 të ngarkuarit me punë për dhjetë shtete: SHBA, Britani, Francë, Gjermani, Itali, Austri, Belgjikë, Zvicër, Turqi dhe Shqipëri.

Kosova ka aplikuar edhe në një numër të madh organizatash ndërkombëtare e rajonale, dhe në mekanizma të tjerë ndërkombëtarë. Është pranuar vetëm në disa sosh, por ka njohur edhe dështime sikur me rastin e mësymjes për t'u bërë anëtare e UNESCO-s dhe Interpolit.

Kosova ende nuk ka siguruar edhe njohjen nga 5 vende anëtare të BE-së – Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia e Qipro – sikurse edhe nga dy prej pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së – Rusia e Kina – të cilat janë pengesë për anëtarësimin e Kosovës në OKB. Mosnjohja nga këto vende shihet si një “guralec në këpucët e Kosovës”, i cili përbën sfidë të madhe në ecjen drejt forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar.

Vendimi i GJND-së dhe efektet

Pa u mbushur gjashtë muaj prej kur Kosova shpalli pavarësinë, shtetësia iu vu në gjyq: Serbia Kërkoi nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së që të kërkojë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë që të japë opinion juridik në çështjen nëse “shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare apo jo”. Autoritetet vendëse dhe aleatët e tyre dështuan që në Asamble ta stoponin këtë iniciativë. Në favor të kërkesës serbe u vendos, kur me 77 vota pro, 74 abstenime dhe 6 kundër, ky forum i OKB-së miratoi Rezolutën 63/3, që mbështetej në nenin 96 të Kartës së OKB-së dhe në nenin 65 të statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Neni 96 i Statutit të Gjykatës ia njehtë drejtën vetëm Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit, që të mund të kërkonin mendimin e saj mbi secilën çështje juridike që ka të bëjë me të drejtën ndërkombëtare.

Serbisë i qe kthyer në bumerang kjo iniciativë. Gjykatës i mori dy vite kohë shqyrtimi, për të vendosur në fund: Pavarësia e Kosovës nuk e shkeli të drejtën ndërkombëtare, as rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe as Kornizën Kushtetuese, dokument kryesor juridik në Kosovë kur ishte shpallur pavarësia. Gjyqtari japonez Hisashi Owada e kishte dhënë këtë kumt në një gjykatore në Hagë, por tek pasi për gati një orë kishte lexuar faqe të tëra arsytimi. Vendimi gjyqësor lidhur me kontestin që i bëhej pavarësisë së Kosovës u mor me 10 vota pro dhe 4 kundër.

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë u nxor me 22 korrik 2010, ndërkaq më 9 shtator të atij viti Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë, nëpërmjet së cilës “merret në konsideratë” mendimi këshillëdhënës i GJND-së.

Verdikti ishte pritur me entuziazëm në Kosovë. Në një seancë të veçantë, të nesërmen Kuvendi miratoi një Deklaratë, në të cilën ishte shprehur kënaqësia dhe ishte aprovuar opinioni i Gjykatës.

E, Grupit Drejtues Ndërkombëtar kishte nxjerrë një deklaratë, në të cilën rikonfirmohej “mbështetja e palëkundur” e tij për “pavarësinë e pakthyeshme të Kosovës demokratike dhe shumetnike në kufijtë e saj të tanishëm” dhe i bënte thirrje shteteve tjera që të njohin Kosovën. Një nga efektet e para që kishte deklarata, është se ajo prodhoi dialogun. Në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, përsëritet gatishmëria e Bashkimit Evropian për të lehtësuar një

proces dialogu midis palëve, i cili do të promovonte “bashkëpunimin, arritjen e përparimit në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve”²⁴.

Efekte të menjëhershme të këtij zhvillimi nuk ishin parë. Përgjatë 2010-s Kosova kishte siguruar njohje vetëm nga edhe 8 shtete, pesë prej të cilave vendimin e kishin publikuar para se GJND-ja ta deklaronte mendimin për pavarësinë. Megjithëkëtë, Kosova e ka përdorur atë, si një armë të fortë në argumentimin pro njohjes. Thelbi i verdiktit është përfshirë edhe në një marrëveshje me Serbinë për përfaqësimin e Kosovës në nisma rajonale. Mbështetur në të, mbi emrin e Kosovës vendoset një asterisk dhe fusnota që shpjegon atë, përmban edhe mendimin e GJND-së.

“Pavarësimi” nga ndërkombëtarët

Plani Ahtisaari përmbante provizione, sipas të cilave, pavarësia duhej mbikëqyrur. Ishte paraparë edhe një proces transitor, nëpërmjet së cilit në mënyrë graduale kompetenca ekzekutive që mbanin shefi i misionit të OKB-së, si autoritet suprem që ishte, si dhe misionet për siguri e polici, por edhe të tjera, të kalonin kompetencat tek autoritetet vendore.

Më pak se dy javë prej kur Kosova e kishte shpallur pavarësinë, ishte formuar Grupi Drejtues Ndërkombëtar, në të cilin, në nivel të lartë zyrtarësh, ishin përfaqësuar: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Sllovenia, Zvicra, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Grupi kishte për mision të orientojë dhe mbikëqyrë zhvillimin demokratik të Kosovës, të nxisë qeverisjen e mirë dhe shumëetnicitetin, të cilat promovoheshin në Planin Ahtisaari.

Nga 10 shtatori i 2012-s, formalisht Kosovës i është hequr mbikëqyrja. Vendimi ishte marrë në Prishtinë në një takim të Grupit Drejtues Ndërkombëtar. Vetëm një javë më përpara, në Vjenë ishte mbajtur takimi i pesëmbëdhjetë i këtij Grupi, në të cilin midis të tjerash ishte konstatuar se “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit është zbatuar në mënyrë substanciale dhe me këtë autorizohen hapat përfundimtar për përmbyllje të pavarësisë së mbikëqyrur dhe mbyllje të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO)”. E, në Deklaratën ku jepet kumti për heqjen e mbikëqyrjes, theksohet, ndër të tjera, se pakoja e Ahtisaarit është zbatuar në mënyrë substanciale dhe se është vërë re se, në përputhshmëri me zotimet e tyre, institucionet e Kosovës tani i kanë miratuar pakot e ndryshimeve të Kushtetutës dhe të legjisllacionit primar, duke i përfshirë në mënyrë të kënaqshme elementet e mbetura të Pakos, brenda kornizës kushtetuese dhe juridike të Kosovës. Ky konsiderohej si vlerësimi më i lartë ndërkombëtarë që i ishte bërë Kosovës që nga shpallja e pavarësisë.

Kësisoj, bashkë me përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, i ishte përmbyllur edhe mandati Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, i cili, përgjatë kohës së mbikëqyrjes, kishte autoritet suprem në Kosovë.

E, para shpalljes së pavarësisë, autoritetin suprem në Kosovë e ka ushtruar shefi i misionit të Kombeve të Bashkuara, UNMIK. Misioni e ka tkurrur prezencën, që prej kur Kosova është bërë shtet, dhe fare pak është aktiv. Në anën tjetër, misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX, ka ruajtur fare pak kompetenca ekzekutive dhe ndodhet në prag të “paketimit”. Qershori është muaji kur i përfundon mandati.

²⁴Resolution adopted by the General Assembly on 9 September 2010. Në dispozicion në: http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/%20RES/64/298.

Kontrata me BE-në

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përbën marrëdhënien e parë kontraktuale që Kosova e ka lidhur me Bashkimin Evropian. Dokumenti, përpos që i futi në një fazë të re raportet me Brukselin zyrtar, obligon shtetin e ri të ndërmarrë një numër të madh reformash në të gjitha fushat, në mënyrë që të përafrohen me standardet evropiane.

Marrëveshja mbështet tranzicionin ekonomik të Kosovës dhe siguron zhvillimin gradual të një zone të tregtisë së lirë me BE-në. Krahas kësaj, stimulon qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. MSA-ja përmban dhjetë kapituj kryesorë, shtatë shtojca, pesë protokolle dhe një deklaratë të përbashkët.

Qeveria e ka pranuar që, në mënyrë që Kosova ta shfrytëzojë plotësisht MSA-në dhe mundësitë ekonomike që ofron, ajo duhet të shoqërohet me reforma urgjente ekonomike, si dhe të përcillet me sundim të ligjit. Në një agjendë²⁵ reformash, ekzekutivi ka theksuar se institucionet e fuqishme dhe eficiente, gjyqësori i pavarur dhe me resurse të duhura, si dhe vullneti politik për ta luftuar fuqishëm korrupsionin, janë kyçe për zhvillim, rritje ekonomike dhe punësim. Prej dy vitesh, Qeveria harton në secilin vit Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, e edhe Agjendën për Reforma Evropiane, në të cilat listohen veprimet afatshkurtra e afatmesme që duhet ndërmarrë, në funksion të përmbushjes së MSA-së. Në dy vitet e shkuara, kur vendi është përballur me kriza e ndërçës politike, të dy dokumentet janë zbatuar në shkallë të pakënaqshme, por agjendën evropiane, autoritetet²⁶ e kanë deklaruar si top prioritet në këtë mandat.

Krahas shtytjes që ju jep këtyre reformave, MSA-ja ka kapërcyer një nga problemet që Kosova kishte në komunikimin formal me BE-në.

BE-ja evitoi bllokimin e marrëveshjes nga pesë vendet anëtare të saj që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës – Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja. Aplikoi një strategji në këtë rast. Vendimmarrja rrodhi tek pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, sipas të cilit marrëveshjen me palët tjera e bën vetëm BE-ja dhe ajo me automatizëm njihet nga të gjitha shtetet anëtare. E, me traktatin e mëhershëm të Nicës, MSA-ja nuk kishte gjasë të kalonte. Kjo për faktin se ai kërkonte që marrëveshja të miratohej nga të gjitha shtetet anëtare veç e veç, përfshirë pesë vendet që nuk ia njohin pavarësinë Kosovës, dhe që tek pastaj të kalonte në Këshillin e BE-së.

Para se të firmosej, MSA është miratuar nga Komisioni Evropian më 30 prill 2015, ndërsa nga Këshilli i BE-së më 22 tetor 2015. Inicialet në marrëveshje ishin vënë në korrik të vitit 2014, por procesi i hyrjes në fuqi qe ngadalësuar për shkak të mungesës së konsensusit brenda BE-së dhe gjetjes së zgjidhjes për ta kaluar situatën.

Jo veç BE-ja evitoi pengesat për ta çuar përpara këtë marrëdhënie me Kosovën. Në kohën kur MSA-ja është vu për ratifikim para deputetëve të Kosovës, pushteti e opozita zhvillonin përplasjet më të mëdha në historinë e tij që njeh Kuvendi. Opozita kundërshtonte marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi e edhe formimin e Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe, kalimin e të cilave e pengonte duke hedhur gaz lotsjellës në Kuvend e duke organizuar protesta masive në rrugë. Nuk lejonte as çështje të tjera të viheshin për shqyrtim, pa u përmbushur kërkesa që lidhej me anulimin e të dyja marrëveshjeve. Mirëpo, kishin bërë përjashtim për MSA-në, e cila ishte ratifikuar në paqe, meqë subjektet politike opozitare nuk penguan seancën, e madje

²⁵Dialogu I nivelit të lartë Kosovë-BE për prioritetet kyçe: Agjenda për Reforma Evropiane (2016). Në dispozicion, në: <http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf>.

²⁶Koha.Net (2017) "Veseli: Agjenda evropiane është prioritet kryesor i Kosovës". Në dispozicion, në <http://www.koha.net/arberi/47217/veseli-agjenda-evropiane-eshte-prioritet-kryesor-i-kosoves/>. Koha.Net (2017) "Haradinaj: Prioritet i Qeverisë mbetet agjenda evropiane". Në dispozicion, në: <http://www.koha.net/arberi/56452/haradinaj-prioritet-i-qeverise-mbetet-agjenda-evropiane/>.

i kontribuuan asaj në debatin e zhvilluar aty. Në Kuvend u konsiderua se ratifikimi përbënte ngjarjen më të madhe për Kosovën, që prej shpalljes së pavarësisë.

Gjykatë Speciale për “Raportin Marty”

Pa i mbushur tri vjet, Kosova u trondit nga një raport ndërkombëtar, i cili përmban pretendime se njerëz të UÇK-së kishin kryer krime çnjerëzore, përfshirë heqjen e organeve të disa serbëve dhe disa shqiptarëve, gjatë dhe menjëherë pas luftës që përfundoi në qershor të 1999-s. Autor i raportit ishte senatori Dick Marty, ndërsa në janar të 2011-s dokumenti u aprovua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Raporti hedh pretendime inkriminuese mbi shumë eksponentë të UÇK-së, disa prej të cilëve prej pasluftës e deri tash kanë funksione të larta shtetërore. Akuzat u kundërshtuan rreptë në Kosovë, por ato përbënë lajm në gjithë globin. Përmbajtjen, gazeta britanike “The Guardian” e nxori në ballinë, si lajm qendror.

Në shtator të vitit 2011, Bashkimi Evropian formoi Task Forcën Hetimore Speciale, me mandat për të zhvilluar hetime të pavarur të pretendimeve të ngritura në raport dhe krimeve të tjera në lidhje me to. Katër vite më vonë, kjo task-forcë kumtoi se ekzistonin prova të mjaftueshme për ngritje aktakuzash, por se nuk ishin gjetur dëshmi bindëse për heqje të organeve për qëllim transplantimi. Aktakuzat nuk mund të ngriheshin, pa një institucion gjyqësor.

Pas këmbënguljes së komunitetit ndërkombëtar dhe një numri të madh negociatash, autoritetet e Kosovës mbërritën marrëveshje me BE-në mbi modalitetet për procedimin e pretendimeve që përmban raporti. Kundërshti e protesta zgjoi ky pranim. Megjithëkëtë, gjatë verës së 2015-s, Kuvendi miratoi ndryshime kushtetuese dhe aprovoi Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, me mandat për të trajtuar krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krime të tjera të përmendura apo të ndërlydhura me raportin e senatorit Marty. Mbështetur në këto ndryshime, gjykata u vendos në Hagë të Holandës. Ajo përbëhet vetëm nga ndërkombëtarë dhe nuk ka ndonjë detyrim llogaridhënës ndaj çfarëdo autoriteti të Kosovës.

Gjatë verës së fundit, Dhomat e Specializuara, të cilat përbëjnë gjykatën e Speciales, janë funksionalizuar plotësisht. Atëkohë ka hyrë në fuqi Rregullorja e procedurës dhe e provave, pa të cilin dokument nuk konsideroheshin të funksionalizuara plotësisht Dhomat e Specializuara. Ndonëse pas kësaj rrethane Dhomat mund të merrnin parashtrime dhe të nisnin procedurat gjyqësore, akoma nuk ka një aktakuzë të shpallur.

Në fundvit, liderët kryesorë institucionalë kanë bërë orvatje të shumta për ta jetësuar iniciativën e subjekteve në pushtet që ta shfuqizojnë Ligjin për këtë gjykatë, ani se përfaqësuesit e SHBA-ve e edhe të BE-së alarmonin se një vendim i këtillë do ta izolonte ndërkombëtarisht Kosovën. Kryesia e Kuvendit ka bërë dy tentativa për të shqyrtuar kërkesën e 43 deputetëve nënshkrues për seancë të jashtëzakonshme, në të cilën do të paralizohej Specialja. Para këtij zhvillimi, ishte raportuar²⁷ se kreu i shtetit Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, qëndronin pas një peticioni të organizatave të dala nga lufta, me të cilin kërkohej rrëzimi i Speciales. Megjithëkëtë, në fillim të 2018-s, të dy kanë konfirmuar se iniciativa nuk do të ecë tutje dhe se mandati i Speciales do të mbetet i paprekshëm. Bashkëpunimi i Kosovës me këtë Gjykatë është pritja që Bashkimi Evropian e ka listuar në Strategjinë e re të zgjerimit.

²⁷Koha Ditore (16.12.2017). “Peticioni për Specialen i ‘shtyrë’ nga Thaçi e Haradinaj”.

Përballja me ekstremizmin

Terrorizmi ka përbërë preokupimin kryesor për botën, në dekadën e fundit. Nga akte terrori pësuan shumë civilë në Lindjen e Mesme dhe në shtete të ndryshme të Perëndimit, ndërsa edhe Kosova nuk i shpëtoi kërcënimeve.

Aktet motivoheshin kryesisht nga luftërat në Lindjen e Mesme, në të cilat, si vullnetarë, kishin shkuar edhe një numër kosovarësh. Ata ishin përfshirë në luftërat në Siri e Irak dhe një pjesë e tyre ishin rekrutuar në Shtetin Islamik, organizatë që mori përsipër shumicën e akteve të terrorit me të cilat u godit Perëndimi. Të dhëna zyrtare për numrin e saktë të kosovarëve të përfshirë në këto luftëra nuk janë dhënë, por të përafërta po. Autoritetet kanë përmendur rreth 300 sish, gjysma e të cilëve janë kthyer, mbi 60 janë vrarë dhe disa vazhdojnë të qëndrojnë në zonat ku ende ka konflikt.

Nisur nga ky realitet, Kosova ka ndërmarrë një varg masash për të parandaluar shkuarjet e reja. Në mars të 2015-s është miratuar një ligj, sipas të cilit anëtarësimi dhe pjesëmarrja në ushtri të huaja, polici, grupe paraushtarake apo para-police, përbënte një shkelje kriminale, të dënueshme me burg nga 3 deri në 15 vjet. Dënime parashihen edhe për indoktrinuesit e propaganduesit e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm. Financimi direkt apo indirekt apo ofrimi i ndihmës materiale ndaj një personi që synon të anëtarësohet me një grupi ushtarak të huaj, sipas ligjit, është i dënueshëm me burg nga 3 në 15 vjet.

Në disa aksione police, më shumë se 100 persona janë arrestuar, një pjesë e të cilëve janë liruar për t'u mbrojtur në liri. Ka pasur edhe disa dënime gjyqësore, por edhe lirime nga akuzat. Midis të dënuarve është edhe një shtetas që ka bashkëpunuar me autoritetet e rendit, për të sjellë në Kosovë një fëmijë, babai i të cilit e kishte marrë me vete në Siri, pa dijeninë dhe miratimin e bashkëshortes.

Që në vitin 2009, Qeveria ka hartuar strategjinë e parë kundër terrorizmit, dokument që, përveçqë liston mekanizmat e nevojshëm, ka ofruar edhe një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Megjithëkëtë, atëkohë frika ishte në dikë tjetër. Marrëdhëniet ndëretnike mes dy komuniteteve më të mëdha, shqiptarë dhe serbë, vazhdojnë të mbeten të tensionuara, veçanërisht në veri të vendit, ku vazhdojnë të jenë prezent dhe aktive grupe ekstremiste, për të cilat Qeveria thoshte se ishin të predispozura të përdornin dhunën për arritjen e qëllimeve politike. Prej atëherë janë hartuar edhe dy strategji të reja, e fundit ajo e fundvitit, e cila i referohet periudhës 2018-2022. Në këto dokumente, thuhet se gjithë vëmendja i kushtohet ekstremizmit me bazë religjioze që shpie në terrorizëm, e që shihet si kërcënim për vendin. Autoritetet u kanë bërë thirrje edhe kosovarëve të mbetur në zonat e luftës që të kthehen në atdheun e tyre dhe trajtimin e tyre e kanë paraparë edhe në Strategjinë Nacionale për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar.

Garanci për komunitetet

Një kuadër i avancuar ligjor që e ka nxjerrë Kosova para dhe pas shpalljes së pavarësisë, garanton të drejta dukshëm më të mëdha për komunitetet joshumicë, sesa ato që ofrohen nga shtetet e rajonit. Në Kushtetutë përcaktohen "të drejta të veçanta", krahas kuadrit që promovon barazi në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore.

Kosova përbëhet nga shqiptarët shumicë, dhe komunitetet e tjera që në total përbëjnë më pak se 10 për qind të popullsisë: serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjt, egiptianët, goranët, etj. Përpos Kushtetutës që numëron të drejtat, janë nxjerrë edhe ligje specifike që i detajojnë ato, sikur Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre

në Kosovë, Ligji për përdorimin e gjuhëve, ligjet e arsimit dhe Ligji për trashëgiminë kulturore. Në të gjitha janë mishëruar garancitë që ofrohen edhe në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, një pjesë e madhe e të cilit dokument trajton të drejtat shtesë për komunitetet, e veçmas për atë serb.

Komisioni Evropian, në raportin²⁸ e fundit periodik për Kosovën, ka konstatuar se struktura institucionale dhe mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve pakicë janë në rregull në nivel qendror dhe lokal. Veç kësaj, ka konstatuar se situata e përgjithshme e sigurisë për komunitetet pakicë mbetet relativisht e qëndrueshme dhe kryesisht e pandryshuar. Atyre u garantohet përfaqësim në të gjitha institucionet e nivelit qendror e lokal.

Kuvendi i Kosovës ka pesë nënkryetar, dy nga të cilët janë nga komunitetet pakicë. Për ta janë të garantuara edhe 20 nga 120 ulëset sa i ka legjislativi. Secili ndryshim kushtetues kushtëzohet edhe nga vota e së paku dy të tretave të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet pakicë, sikurse edhe për miratimin e ligjeve për një listë çështjesh, ata e gëzojnë të drejtën e “vetos”. Prej dy vitesh, ndryshimet e hartuara në Ligjin për arsimin e lartë nuk kanë kaluar, shkaku i mungesës së votës së deputetëve serbë që përbëjnë gjysmën e ligjvënësve nga komunitetet.

Qeveria e këtij mandati ka një zëvendëskryeministër dhe dy ministra serbë dhe një ministër turk. Ka disa zëvendësministra nga radhët e komuniteteve. Edhe Kushtetuta përcakton se, në Qeveri do të jenë së paku një ministër nga komuniteti serb dhe një nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria obligohet të ketë edhe një ministër të tretë.

Dispozita garantojnë përfaqësim edhe në nivel lokal. Atyre u takon me automatizëm posti i nënkryetarit, në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind të banorëve u përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë.

Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet. U sigurohet përfaqësim i barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu policinë. Gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhët zyrtare të Kosovës dhe kanë status të njëjtë në institucionet e saj. Ndërkaq, gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal.

Universitetet publike ofrojnë kuota të veçanta regjistrimi për studentët nga komunitetet. Të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin.

Komunat e veriut të banuara me serbë kanë kompetenca shtesë në arsim e shëndetësi. Ato bashkë me komuna të tjera me shumicë serbe, kanë të drejtë në organizimin brenda një Asociacioni, për të cilin ka një marrëveshje Kosovë-Serbi, por që akoma nuk është funksionalizuar. Komunat e veriut të banuar kryesisht me serbë, janë të vetmet që përfitojnë nga i gjithë buxheti që përmban taksat doganore që arkëtohen në dy pikëkalime kufitare me Serbinë.

Mësimi nga vjedhja industriale e votës

Pas 2008-s, Kosova fitoi të drejtën që vet t'i organizojë zgjedhjet e të dyja niveleve – qendror e lokal – e të cilat deri në atë kohë ishin menaxhuar nga misioni i OSBE-së. Dështoi në testin e parë. Zgjedhjet e para lokale u mbajtën në vitin 2009. Ato u vlerësua të ishin zgjedhjet më keq të organizuara prej se Kosova ishte çliruar në vitin 1999. Zgjedhjet e para për Kuvendin e Kosovës u mbajtën në fund të 2010-s dhe shumë më shumë parregullsi pati në to. Në këtë proces ka pasur

²⁸Komisioni Evropian, “Raporti i vitit 2016 për Kosovën*”. Në dispozicion, në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf.

diplomatë sikur Christopher Dell, i cili atë kohë ishte ambasador i SHBA-ve në Kosovë, që kanë thënë të ishin dëshmitarë të “vjedhjes industriale” të votave.

Presioni ndërkombëtar bëri që zgjedhjet të përsëriteshin në tri komuna ku parregullsitë ishin më të mëdha, sikurse edhe në disa qendra votimi në komuna të tjera. Ndërkaq, autoritetet e drejtësisë vendosën të shqiptojnë dënime me burg efektiv për ata që vërtetohej se kishin abuzuar me procesin.

Dhe, ky ka përbërë një moment kthese. Në katër palë zgjedhjet e më pastajme që janë organizuar – dy palë për kryetarë komunash e Kuvende Komunale sikurse edhe dy palë të tjera për Kuvendin e Kosovës – nuk janë parë defekte të rënda me ndikim në rezultat, përveç në disa raste në veriun e banuar me serbë, pjesë në të cilën shteti i Kosovës nuk ka mundur ta shtrijë autoritetin e plotë.

Në 2017-n janë organizuar dy palë zgjedhje – gjatë verës nacionale, e në fundvit lokalet. Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë, në raportin final që e ka publikuar për procesin elektoral që nxori kryetarët e rinj të komunave dhe anëtarë e kuvendeve komunale, dha përfundimin se “në përgjithësi, zgjedhjet u mbajtën në një ambient të qetë dhe konkurrues, duke shënuar kështu një përmirësim krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2013”²⁹. Misioni tregoi se në komunat me shumicë shqiptare zgjedhjet ishin vërtetë konkurruese dhe ambienti i fushatës ishte i qetë, duke u mundësuar kandidatëve të shumtë t’i përcjellin lirshëm mesazhet e tyre tek elektorati. Për dallim, “ambienti i fushatës në shumë komunitete të serbëve të Kosovës u shëmtua nga frikësimi që veçanërisht kishte në shënjestër subjektet politike të tjera nga Lista Serbe dhe kandidatët e tyre”.

Në raport me serbët, nuk ishte sfidë vetëm organizimi i zgjedhjeve. Në shtator të 2013-s, KQZ-ja ua heq partive serbe emërtimin “Srbija”. Ishin dy parti që në emërtim kishin këtë emër, përfshirë Listën Srpska që ka 9 nga 10 deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës dhe udhëheq me shumicën absolute të komunave me shumicë serbe.

Asnjë proces zgjedhor nuk është bojkotuar nga ndonjë subjekt politik me peshë, sikundër që nga i gjithë spektri politik është pranuar rezultati i të gjitha zgjedhjeve që janë organizuar brenda dekadës së parë të shtetit të Kosovës.

Triumfi sportiv

Dy vite pa e përmbyllur dekadën e parë të shtetësisë, Kosova përjeton suksesin më të madh në sport. Në 2016-n xhudistja Majlinda Kelmendi fitoi medaljen e artë olimpike, ndërsa Kosova u bë pjesë e FIFA-s dhe UEFA-s, dy shtëpive më të mëdha të sportit më popullor, futbollit.

Para kësaj, Kosova qe anëtarësuar edhe në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe në shumicën e federatave të atyre sporteve që zhvillohen edhe në Kosovë. Në një numër federatash, anëtarësimi është bërë edhe para 2008-s. Në dy rrafshë u përkthyen këto suksese.

I pari ka të bëjë me përfshirjen e kosovarëve në ngjarjet ndërkombëtare sportive, nga të cilat ishin të privuar deri në atë kohë. Në lojërat olimpike në Brazil, Kosova qe përfaqësuar me 8 sportistë, kurse në olimpiadën dimërore që së fundmi është mbajtur në Korenë e Jugut, me një. Përfaqësueset e Kosovës në sporte morën pjesë në garat kualifikuese për evropian e botëror, sikurqë edhe ekipet në gara të ndryshme kualifikuese. Sukseset kulmore sikur të Kelmendit, bënë që të ndodhnin “paradokse” që dot nuk merreshin me mend. Vetëm disa muaj më përpara lojërave olimpike, garda ushtarake ruse i bëri nder flamurit të Kosovës dhe intonimit të himnit, kur

²⁹Bashkimi Evropian, Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. “Raporti përfundimtar: Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe kuvendet komunale në Kosovë*” (2017). Në dispozicion, në: http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/1-final_report_kosovo_albanian.pdf.

Kelmendi mori vendin e parë në kampionatin evropian të xhudos që u mbajt në Kazan të Rusisë, shtet që përbën pengesën kryesore për anëtarësim të Kosovës në OKB. Ndërkaq, rezultatet në sport bën që mediat më të mëdha botërore t'i bëjnë reklamë “pa pagesë” Kosovës, nëpërmjet storieve të suksesit që prezantonin.

I dyti ndërlidhet me investimet e Qeverisë. Sukseset e tilla bën që autoritetet të kthejnë sytë kah sportistët. Një rregullore e nxjerrë nga Qeveria, siguron bursa olimpike për atletë të dalluar në mënyrë që të përgatiten për olimpiadë, si dhe ofron mbështetje monetare për secilën medalje që sigurohet, si në olimpiadë, po ashtu edhe në kampionate ndërkombëtare. Për shembull, 100 mijë euro është lartësia e shpërblimit për fituesit e të artës olimpike, kurse 50 mijë për trajnerin. Në anën tjetër, pranimi në federata ka imponuar investime në infrastrukturën sportive. Kjo për shkak se përballjet për gara kualifikuese nuk lejohen në stadione e palestra që nuk plotësojnë kriteret minimale të cilat i kërkojnë federatat. Si rezultat, miliona euro Kosova ka investuar në dy stadione futbollit, në Mitrovicë e Prishtinë, sikurse ka nisur një proces fizibiliteti për ngritjen edhe të stadiumit të përfaqësueses, i cili parashihet të kushtojë rreth 50 milionë euro, e edhe janë zotuar mjete për të ngritur një qendër për xhudo në Pejë, qyteti që brenda një dekade ka dërguar në Kosovë, jo vetëm të artën olimpike, por edhe të arta në kampionate botërore e evropiane. Në anën tjetër, “infuzione” financiare klubet kanë përfituar edhe nga federatat ndërkombëtare, si mbështetje për zhvillim të tyre, por edhe si shpërblim për secilin rreth kualifikues që e kalojnë.

Imazhi me art

Kosovës nuk i bënë punë milionat që dha për reklamën në mediat ndërkombëtare, në mësymjen për ta prezantuar sa më mirë imazhin e shtetit të sapolindur. Më shumë se milionat, funksionuan vepra e veprimtari arti që për protagonistë kanë kosovarët, sikur edhe ngjarje kulturore të organizuara nga ta.

Ditën e shpalljes së pavarësisë, në qendër të Prishtinës është vendosur monumenti NEWBORN, që njihet si obelisk i pavarësisë. Ai është ideuar nga Fisnik Ismajli, që prej dy mandatesh është deputet në Kuvendin e Kosovës, ndërsa financiarisht ishte mbështetur nga Qeveria. Imazhi me fotografi nga festa e pavarësisë, e që në qendër ka këtë monument, pati zënë ballinat e shumë gazetave, përfshirë amerikanen “The New York Times”. Si vepër arti, NEWBORN ka marrë disa shpërblime, përfshirë edhe “Luanin e Artë” në Cannes, që për reklamat është sikur çmimi Oscar për filmat.

Dhe, në janar të 2016-s, Kosova mbërrin edhe në Oscar. Është filmi “Shok” që e fut shtetin e ri në historinë e çmimit më prestigjioz në kinematografi. Rrëfimi kosovar që aprovon kufijtë miqësorë të dy fëmijëve në kohë lufte, ishte nominuar për kategorinë “Best Live Action Short”. Filmi është bashkëprodhim midis Kosovës dhe Britanisë së Madhe. Kosova është bërë qendër rajonale për filmin dokumentar dhe të shkurtër. Festivali Ndërkombëtar Dokufest, është ngjarja më e madhe filmike në Kosovë dhe referencë për rajonin. Ajo mbahet në secilin gusht, në qytetin e Prizrenit, dhe tërheq një numër të madh të artistëve nga regjioni dhe bota, por edhe shumë turistë.

Jo vetëm kinematografia pati hise në imazhin e Kosovës, që u prezantua jashtë. Në vitin 2012, këngëtarja me origjinë nga Kosova, Rita Ora, vjen në Prishtinë për të realizur videospotin e këngës “Shine yourlight”, të kthyer në hit botëror. Monumente dhe identiteti i shtetit, promovoheshin në të. Pas kësaj, Atifete Jahjaga, atëkohë presidente e shtetit, e dekoroi Orën me titullin “Ambasadore nderi e Kosovës”. Kosovën e promovuan edhe dy zëra tjerë që pushtuan skenë botërore të muzikës, Dua Lipa e Bebe Rexha.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Analiza e Politikave

Analizat e Politikave janë raporte që diskutojnë politikat publike dhe që synojnë të ndikojnë në vendimmarrje, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror të qeverisjes. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, të shqyrtoj argumentet e ndërlidhura me politikën përkatëse, dhe të analizojë zbatimin e saj. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjërë dhe gjithëpërfshirës mbi çështjen e dhënë, si dhe të ofroj zgjidhje të informuara dhe rekomandime për ndryshimin e politikave publike relevante, kryesisht drejtuar aktorëve dhe grupeve të interesit.



**GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES**

legalpoliticalstudies.org